


# Performanca e Buxhetit 2018



## NË KËTË RAPORT

**Periudha raportimit:** Janar - Dhjetor 2018

**Statusi raportit:** Raporti bazohet në të dhëna të konsoliduara të zbatimit të buxhetit për bashkinë Kamëz gjatë vitit 2018 dhe është miratuar në Këshillin Bashkiak

*Përmbledhje mbi situatën financiare, të ardhurat, shpenzimet sipas programeve si edhe rezultatet kryesore të ekzekutimit të buxhetit për vitin 2018*

*Ky raport është përgatitur nga Bashkia Kamëz me asistencën e Projektit "Bashki të Forta". Për më shumë informacion në lidhje me të kontaktoni me Zj.Vjollca Smaçi në adresën [vjollca.smaci@yahoo.com](mailto:vjollca.smaci@yahoo.com)*

# TË DHËNA TË PËRGJITHSHME



Popullsia: Censuri (2011) 104.190 banorë  
 Rregjistri Civil 125.632 banorë  
 Sipërfaqja: 37.18 km<sup>2</sup>  
 Dendësia: Censuri (2011) 2.802 banorë/km<sup>2</sup>  
 Rregjistri Civil 3.379 banorë/km<sup>2</sup>

Nëndarjet Administrative: 2

(1) Kamëz (2) Paskuqan

Rezultatet në zgjedhjet vendore të vitit 2015 si më poshtë:

10.86%	Partia Demokratike - PD
18.64%	Lëvizja Socialiste për Integrim - LSI
17.87%	Partia Socialiste e Shqipërisë - PS
5.77%	Partia Republikane - PR
2.14%	Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet - PDIU
2.10%	Partia e të Drejtave të Moshuarve e Re - PDM e Re
1.76%	Partia Balli Kombëtar Demokrat - PBKD
1.48%	Partia Demokratike e Shqipërisë - PDK
1.49%	Partia Bashkimi Demokrat - PSD
1.38%	Partia Unitetit Kombëtar - PUK
1.37%	Partia Ligj dhe Drejtësi - PLIDR
1.28%	Partia Bashkimi Liberal Demokrat - BLD
1.12%	Fryma e Re Demokratike - FRD

Shpërndarja e anëtarëve:

12	Anëtarë
9	Anëtarë
8	Anëtarë
3	Anëtarë
1	Anëtarë
1	Anëtarë
1	Anëtarë
1	Anëtarë
1	Anëtarë
1	Anëtarë
1	Anëtarë
1	Anëtarë
1	Anëtarë

**EKZEKUTIVI** Numri i përgjithshëm i zgjedhësve të regjistruar në Bashkinë Kamëz për zgjedhjet vendore të vitit 2015 ishte 89.679 persona. Pjesëmarrja e votuesve në zgjedhjet e fundit lokale ishte 53%. Këshilli bashkiak përbëhet nga 41 anëtarë të grupuar midis partive politike PS, PD, LSI, PR, PDIU.

Kryetari i Bashkisë është **Z. Xhelal MZIU**.

19 departamentet e Bashkisë janë: ekonomi dhe financë; buxheti, tatim taksa vendore, politikat e zhvillimit, shërbimet publike, bujqësia dhe pyjet, shërbimet sociale, planifikim dhe kontrolli i teritorrit, policia bashkiake, mbrojtja e teritorit, ligjore, administrate dhe burimet njerëzore, arsim dhe edukim;

**EKONOMIA** Si një zonë e re urbane dhe me densitet të lartë të popullsisë, zhvillimi i infrastrukturës së duhur për ujësjellës, kanalizime, rrugë, sheshe publike apo parqe si dhe ndërtimi i shkollave, kopshteve, çerdheve e qendrave shëndetësore janë sfidat kryesore të bashkisë.


Bashkia e re numëron rreth 3.050 biznese.

# SITUATA FINANCIARE

- ⇒ Rritja e financimit të shërbimeve publike nga burimet e brendëshme të bashkisë prej të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore pa rritur barrën fiskale.
- ⇒ Përmirësim i menaxhimit buxhetor dhe qëndrueshmëri financiare duke kryer shpenzime buxhetore brenda burimeve të të ardhurave të mbledhura.
- ⇒ Menaxhim i kujdesshëm i fondeve të bashkisë duke kryer shpenzime 100% në nivelin e burimeve financiare.

## 2018 Vs 2017

### Treguesit Financiare



Burimi i Informacionit:  
"FTF 2018 - Bashkia Komë"

## Fakt 2016, 2017, 2018

### Treguesit Financiare



Burimi i Informacionit:  
"FTF 2018 - Situatja e Financiare"

# SHËRBIMET DHE TË ARDHURAT 2018


## Burimet e financimit planifikimi 2018

- ⇒ Transferta e pakushtëzuar (granti)
- ⇒ Transferta specifike
- ⇒ Të ardhurat nga burimet e veta,
- ⇒ Të ardhura të trashëguara nga viti 2017
- ⇒ Transferta e kushtëzuar

**Buxheti për vitin 2018 =**  
**2.236.731 mijë lekë**

## Shërbimet kryesore të ofruara dhe financuara nga bashkia janë

- |   |                                     |
|---|-------------------------------------|
| ⇒ Ekzekutivi & Çështjet e Brendshme         | ⇒ Zhvillimi i komunitetit           |
| ⇒ Shërbime të Përgjithshme                  | ⇒ Furnizimi me ujë                  |
| ⇒ Shërbimet e policisë                      | ⇒ Ndriçimi i rrugëve                |
| ⇒ Shërbimet e mbrojtjes nga zjarri          | ⇒ Shërbimet ambulatorë              |
| ⇒ Rendi publik dhe masat e sigurisë         | ⇒ Shërbimet rekreative dhe sportive |
| ⇒ Çështjet ekonomike, tregtare dhe të punës | ⇒ Shërbimet kulturore               |
| ⇒ Bujqësia, pyjet, peshkimi dhe gjuetia     | ⇒ Arsimi bazë dhe parashkollor      |
| ⇒ Transporti                                | ⇒ Arsimi i mesëm                    |
| ⇒ Industri të tjera                         | ⇒ Shërbime plotësuese në arsim      |
| ⇒ Menaxhimi mbetjeve                        | ⇒ Sëmundje dhe paaftësi             |
| ⇒ Menaxhimi i ujrave të zeza                | ⇒ Të moshuarit                      |
| ⇒ Reduktimi i ndotjes                       | ⇒ Familje dhe fëmijë                |
| ⇒ Mbrojtja e mjedisit                       | ⇒ Papunësia                         |
| ⇒ Zhvillimi i strehimit                     | ⇒ Strehimi                          |




**Buxheti faktit për vitin 2018 =**  
**2.017.845**

# TË ARDHURAT 2018

ecuria e të ardhurave në vite



Të ardhurat në diskrecon të bashkisë, ecuria ne vite




# SHPENZIMET

Bashkia Kamëz i kushton vëmendje gjithnjë e më shumë në rritje shërbimeve sociale dhe infrastrukturës.

Programet buxhetore më të financuara gjatë vitit 2018, që përbëjnë rreth 77% të buxhetit janë:

- A. Menaxhim i rrugëve
- B. Planifikim, Menaxhim, Administrim
- C. Arsimin (parashkollor dhe 9-vjeçar)
- D. Pastrim, gjelbërim, ndriçim
- E. Ndihma ekonomike dhe paaftësi

Pesha e programeve në buxhet 2018



Programi me ekzekutimin më të lartë është Ndihma ekonomike dhe paaftësia, kurse "Emergjencat Civile" ka ekzekutimin më të vogël



Shpenzimet sipas Programeve Buxhetore në Lekë

Program	2017	2018	2018	2018	2018
	2017	2018	2018	2018	2018
Shërbimet publike vendore	29,572,705	58,287,338	58,287,347	96.72%	190.67%
Ujesjelles kanalizime vendore	50,343,919	98,161,237	79,003,583	79.56%	157.18%
Zhvillimi i Sportit	42,444,026	34,534,250	34,638,753	71.25%	58.07%
Arsimi parashkollor dhe 9-vjeçar	120,867,723	182,159,945	180,310,940	93.74%	149.63%
Arsimi parashkollor dhe 9-vjeçar (arsimi-përgjithshëm)	29,711,824	42,748,181	25,598,737	60.08%	128.96%
Arti dhe kultura	2,288,740	2,421,038	2,423,838	100.00%	306.24%
Emergjencat Civile	1,116,349	5,134,319	5,134,319	208.98%	253.70%
Investime dhe shërbime	37,255,296				0.00%
Shërbime mjedite dhe mjedite	9,778,795				0.00%
Shërbime mjedite	475,808,157	798,152,783	691,870,668	86.62%	146.62%
Mësimet e parashkollor dhe 9-vjeçar	77,483,955	2,423,038	2,423,838	100.00%	3.12%
Mësimet e specializuara kanalizime	86,298,917	2,421,038	2,423,838	100.00%	2.81%
Mësimet ekonomike dhe paaftësi	532,273,283	591,762,808	470,354,141	91.75%	88.37%
Planifikim Menaxhim Administrim	188,284,179	246,790,056	292,784,546	82.34%	107.78%
Shërbime gjelbërore	12,303,832	9,796,435	9,391,815	96.68%	76.28%
Shërbime	395,808	3,091,236	88,252	86.17%	221.19%
Ujër dhe ujër	17,730,778	5,626,846	5,685,546	96.67%	30.90%
Zgjidhje të Përgjithshme dhe lokale	5,067,880				0.00%
<b>Total</b>	<b>1,727,895,541</b>	<b>2,136,731,306</b>	<b>2,027,844,933</b>	<b>94.92%</b>	<b>116.78%</b>

Burimi i informacionit: Raporti i Monitorimit 2018 - Bashkia e Kamëz

# SHPENZIMET

Në grafik paraqitet pesha e investimeve ndaj totalit të buxhetit



# TREGUESIT E PERFORMANCËS

Rezultatet vjetore të treguesve të performancës buxhetore



Bashkia ka rritur performancën e përdorimit të fondeve buxhetore. Kjo rritje ka ardhur edhe në sajë të rritjes së transparencës së vendimarrjes bashkiake.

Të gjitha mbledhjet e Këshillit Bashkiak kanë qenë të hapura dhe pjesa më e madhe e vendimeve që detyrojnë konsultimin me publikun janë diskutuar paraprakisht me banorët.

Disa arritje të rëndësishme të përmirësimit të shërbimeve ofruar komunitetit vendor falë rritjes jo vetëm të burimeve financiare, por edhe të kapaciteteve njerëzore të bashkisë janë renditur më poshtë nëpërmjet treguesve të performancës sipas programeve.



# PROGRAMI


## PLANIFIKIM, MENAXHIM, ADMINISTRIM

### Objektivi i programit

Përmirësim  
administrativ të  
bashkisë

### TREGUES PERFORMANCE

- ⇒ Realizimi i pagesës së pagave dhe të sigurimeve shoqërore për nënpunësit dhe punonjësit e bashkisë.
- ⇒ Plotësimi i kërkesave për kushte normale të punës në administratë nëpërmjet procedurës së prokurimit për blerje dokumentacioni, shërbim printimi
- ⇒ Sigurimi i materialeve dhe shërbimeve speciale
- ⇒ Realizimi i shërbimeve ndaj të tretëve.
- ⇒ Realizimi i shpenzimeve të transportit.
- ⇒ Sigurimi i lëvizjes së nënpunësve dhe realizimi i shpenzimeve të transportit.
- ⇒ Mirëmbajtja e mjeteve të transportit, pajisjeve të zyrave dhe vetë ambienteve të zyrave nëpërmjet realizimit të shpenzimeve të mirëmbajtjes së zakonshme.
- ⇒ Realizimi i shpenzimeve të tjera operative.



# PROGRAMI


## SPORTI DHE KULTURA

### Objektivi i programit

Nxitja, zhvillimi dhe përhapja e kulturës sportive në komunitetin

### TREGUES PERFORMANCE

Nëpërmjet fondeve buxhetore për zhvillimin e sportit bashkia mbështet masivizimin dhe konsolidimin e sistemit sportiv në dobi të shëndetit të shoqërisë që nga fëmijët e kopshteve, të rinjtë, studentët dhe të rriturit.



# PROGRAMI

## ARSIMI BAZË DHE PARASHKOLLOR DHE PARAUNIVERSITAR

### Objektivi i programit

Përmirësimi i infrastrukturës në institucionet arsimore


### TREGUES PERFORMANCE

Përmbushja me sukses e të gjitha detyrimeve ligjore në fushën e arsimit.

Synimi i përmbushjes së standarteve të miratuara nga M.A.SH në Strategjinë e Arsimit.

Përmirësimin dhe rritjen e efektivitetit në cilësinë e shërbimeve ndaj institucioneve arsimore si dhe në forcimin e kontrollit të fondeve të planifikuara në buxhetin e arsimit.

Të realizojë mirëmbajtjen e kopshteve, çerdheve, dhe shkollave të qytetit, duke synuar përmbushjen e standarteve optimale në ambientet e mësimdhënies



# PROGRAMI

## MENAXHIMI I MBETJEVE BASHKIAKE

### Objektivi i programit


Përmirësimi i ambientit dhe ulja e ndotjes në qytet. Zgjerimi shërbimit në të gjitha njësitë administrative

### TREGUES PERFORMANCE:

Bashkia nëpërmjet këtij programi financon:

- ⇒ pastrimin e rrugëve dhe shesheve kryesore të qytetit; Grumbullimin dhe heqjen e mbetjeve urbane në pikat e vend-qëndrimeve të kontenierëve dhe pikave statike;
- ⇒ Grumbullimin dhe heqjen e mbetjeve inerte në pikat e vendgrumbullimeve dhe pikave statike çdo ditë;
- ⇒ Larja dhe lagjen e rrugëve, në rrugët dhe sheshet kryesore të qytetit për uljen e ndotjes mjedisore nga qarkullimi i makinave dhe punimet ndërtimore;
- ⇒ Përmirësimi i kushteve teknike në vend depozitimit të mbetjeve urbane për uljen e ndotjes së ambientit të qytetit;

Aktualisht ky shërbim ofrohet nëpërmjet sipërmarrjes me operator privat, vlera totale e buxhetit të bashkisë që financon këtë shërbim është mbi 90 milionë lekë ose rreth 4% e buxhetit të bashkisë.



# PROGRAMI

## TRANSPORTI PUBLIK

### Objektivi i programit

Mundësim i një qarkullimi normal për këmbësorët dhe mjetet, krijimin e kushteve infrastrukturore për transport publik për komunitetin


Nëpërmjet përmirësimit të infrastrukturës rrugore bashkia ka realizuar studime për rehabilitimin, e rrugëve aktuale, shtrimin e rrugëve të reja; ndërtimin e linjave të transportit publik etj. Njësia e shërbimit për mirëmbajtjen e rrugëve ka 9 punonjës. Gjatë vitit 2018 bashkia ka realizuar disa projekte të cilat pritet të përfundojnë në vitet në vazhdim.

### TREGUES PERFORMANCE:

Bashkia e mat performancën e këtij shërbimi duke krahasuar sipërfaqet e mirëmbajtura nga njëri vit në tjetrin.

- ♦ **TP 1.** Shtimi i sipërfaqeve të mirëmbajtura (vjetore në %)

Gjatë vitit 2018 bashkia ka shtuar me 5% sipërfaqet e mirëmbajtura kundrejt vitit 2017, objektivi i cili mbetet po kaq ambicioz edhe për tre vitet e ardhshme. Të gjitha rrugët / sipërfaqet e mirëmbajtura kishin pasur ndërhyrje për herë të fundit para pesë vitesh.



Burimi: PBA, Bashkia Kamëz

# PROGRAMI

## UJI I PIJSHËM DHE KANALIZIMET

### Objektiva

*Përmirësimi i ofrimit të shërbimit të ujit të pijshëm  
Përmirësimi i menaxhimit të ujërave të përdorura (zeza dhe bardha) / shërbi-  
meve sanitare*

*Bashkia Kamëz mbulon rreth 48% të popullatës me shërbimin e ujit të pijshëm dhe mbi 30% të popullatës me kanalizime sanitare.*

*Ky është një shërbim i ri për bashkinë pasi deri vonë ky shërbim ka qënë ofruar nga UK Tiranë.*

*Pas reformës territoriale bashkia filloi organizimin e këtij shërbimi vetë.*

*Bashkia ka hartuar projekte për ngritjen e shërbimit të grumbullimit dhe transferimit të ujërave të zeza, projekte investimesh që shkojnë mbi 90 milionë lekë në vit dhe që do të zbatohen në vitin e ardhshëm.*

### TREGUES PERFORMANCE

Treguesit e performancës së këtij shërbimi të ofruar për bashkinë janë:

- ◆ **TP1.** Popullsia e mbuluar me shërbimin e ujit të pijshëm dhe kanalizime në %
- ◆ **TP2.** Norma e arkëtimit të tarifave në %
- ◆ **TP3.** Norma e mbulimit të kostove të shërbimit nga të ardhurat e realizuara nga tarifa e shërbimit në %
- ◆ **TP4.** Kohëzgjatja e ofrimit të ujit të pijshëm në 24 orë

Projektet për KUZ	Fillon	Mbaron
KUZ+KUN rrugët Demokracia		
Bashkim Gazidede -Frutikulture	2019	2020
KUZ+KUN rrugët Kujtesa, Nato, Ballsh deri në lum	2019	2020
Ndërtim i linjës së Ujesjellësit lagja 4 Kamëz	2019	2020

